



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca
Kompjuterike”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë “ Universiteti "Aleksandër Moisiu",
Durrës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof.Dr. Thoma KORINI
Dr. Miranda HARIZAJ**

Dhjetor / 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” ofruar nga Institucioni
i Arsimit të Lartë “Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca kompjuterike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.350, date 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR shkresë Nr 7242/1, date 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 336, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	27/4 Bazuar në ngarkesën mësimore rezulton: 87 % PAE / 13% PAK
18	Numri i studentëve:	276 studentë (për një cikël të plotë studimi)
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2005, pas liçensimit të tij, me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005. Universiteti "Aleksandër Moisiu" është riorganizuar me VKM nr.685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" dhe me VBA 10, datë 07.04.2017 është realizuar akreditimi i parë institucional. Njësitë kryesore të institucionit janë:

1. Fakulteti i Biznesit
2. Fakulteti i Edukimit
3. Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

IAL ka zhvilluar procesin e fundit të vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me VBA Nr. 18, datë 24.03.2022 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike.

Me VKM nr.685, date 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", hapet programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", pjesë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Ky program është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë, përshtatjen e programit me Vendim Senati Nr. 72, datë 14.06.2018 miratuar nga MASR me shkresë Nr 7242/1, datë 31.08.2018. Aktualisht programi ka hyrë në procesin e akreditimit. Kohëzgjatja e tij normale është 3 vite dhe numri krediteve të tij është 180 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar nga ASCAL në përputhje me Manualin 2017 dhe. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.Dr. Thoma KORINI dhe Dr. Miranda Harizaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Zj. Anilda Beqiraj.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, e përbërë nga 83 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit kanë realizuar vizitat në datë 15-16 Qershor 2023, në institucion sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kritereve të standarteve shtetërore të cilësisë nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës " është njohur me DRVJ më datë 10.11.2023, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 15/177 Prot datë 10.11.2023.

Universiteti dërgon me anë të shkresës Nr 2114 Prot, datë 21.11.2023 komentet mbi Draftin , ku konfirmon dakortësinë mbi vlerësimin e kryer.

Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Handwritten signature or initials in blue ink.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD në vazhdim), GVJ konstaton se në misionin e tij, UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Pjesë e misionit të UAMD është të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar dhe ndërkombëtar të punës. Në planin strategjik UAMD synon një identitet të fortë dhe të qartë, nëpërmjet forcimit të gjitha këtyre pikave, duke e bërë Universitetin "Aleksandër Moisiu", kompetent, konkurrues në vend dhe të projektuar drejt hapësirës ndërkombëtare të Arsimit të Lartë. Gjithashtu, në misionin e tij Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), që mbulon dhe programin Bachelor në "Shkenca kompjuterike" synon të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushat e teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, mësuesisë, sistemeve të informacionit dhe multimedias.</p> <p><i>DVV Evidencë 1. Statuti UAMD, neni 4; DVV Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025 dhe DVV Evidenca 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në "Shkenca kompjuterike" është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së UAMD. GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit në të cilën shkencat kompjuterike janë përcaktuar si një nga programet prioritare, kjo e mbështetur dhe me rregulloret përkatëse.</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe	

<p>në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p><i>DVV Evidencë 1. Statuti UAMD, neni 4; DVV Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; DVV Evidencë 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidencë 35. Riorganizimi i programit të studimit bachelor SHK (2018).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstaton, nga vlerësimi i dokumentacionit, vizitës në institucion dhe dokumentacionit shtesë të kërkuar, se UAMD ka përvojë 18 vjeçare në fushën akademike dhe disponon kapacitetet si në infrastrukturë dhe burimet e nevojshme për këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet nga DSHK. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 73 pedagogë, <u>nga të cilët 45 janë PAE</u> nga ku: 5 janë me gradën Prof.Asoc.Dr., 18 me gradën Dr dhe 22 asistent lektorë me Master i Shkencave, nga të cilët 17 janë në process doktore dhe <u>28 janë PAK</u>, nga të cilët 1 me gradën Prof.Dr, 3 me gradën Prof.Asoc. Dr, 3 me gradën Dr. dhe 21 Asistent Lektorë me Master i Shkencave. Ndërsa DSHK ka 16 PAE dhe 10 PAK.</p> <p><i>DVV Evidencë. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabelat 1 dhe 2 dhe DVV Evidencë 12. CV e stafit akademik të SHK.</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2010. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu 9 programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike: 2 programe profesionale 2 vjeçar, 3 në Bachelor, 3 në Master Profesional dhe 1 në Master i shkencave. Në misionin e rregullores së programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është cituar se “ky program është projektuar për të rinjtë që kanë përfunduar ciklin e mesëm të studimeve dhe dëshirojnë të ndjekin studimet universitare në fushën e shkencave kompjuterike, duke u fokusuar në përgatitjen e profesionistëve të rinj të aftë për të projektuar dhe ndërtuar programe kompjuterike në platformat desktop, web etj.” Këto fusha janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjës për këtë program.</p> <p><i>DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca</i></p>

	64. Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 3;			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UAMD ka në misionin e tij, në misionin e tij ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. - Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ evidenton se UAMD ka eksperiencë 18 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet si në mbështetje të fushës së shkencave kompjuterike, në infrastrukturë dhe burimet e nevojshme. - Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej vitit 2010. - Fusha e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se UAMD siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive e personelit në rregulloret respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se DSHK menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë, programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.



<p>vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><i>DVV Evidencë 3. Rregullore UAMD; DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore e programit të studimit, Bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidencë 8. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; DVV Evidenca shtesë. Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKSC dhe DVV Evidenca shtesë. Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ evidenton se UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani të biznesit në funksion dhe të këtij programi studimi.</p> <p><i>DVV Evidenca shtesë. Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca shtesë. Lista e marrëveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK; DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System dhe DVV Evidencë Marrëveshje Clean Score.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione apo kompani të biznesit (si psh. Crystal System) në funksion dhe të praktikave profesionale. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet.</p> <p><i>DVV Evidenca shtesë. Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKS; DVV Evidenca shtesë. Lista e marrëveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK; DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System dhe DVV Evidenca shtesë. Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>UAMD në raportin vjetor të vetëvlerësimit paraqet një analizë të bashkëpunimit me aktorët e jashtëm dhe përfitimit në kuadër të procesit mësimor dhe formues.</p> <p><i>DVV Evidenca shtesë. Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKSC dhe DVV Evidenca shtesë. Lista e marrëveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK.</i></p>



Konkluzione	<p>- Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DVV dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës GVJ konstaton se UAMD ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional dhe mobilitetit.</p> <p>- UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total 180 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. Përqindja sipas secilit tip të komponentit mësimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët bazë 20%; • Lëndët karakterizuese 54%;




	<ul style="list-style-type: none"> • Lëndët ndërdisiplinore 13%; • Lëndët plotesuese 10%; • Detyrimet përmbyllëse 3 %. <p><i>DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore e programit te studimit, Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 3 dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/SHK.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” synon t’i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në programimin, zbatimin e aplikacioneve, komunikimin, menaxhimin e bazave të të dhënave, zhvillimin e softwareve, zhvillimin e website-ve, mediat dixhitale dhe publikimet elektronike, etj. Në të njëjtën synojnë të aftësojnë studentët në planifikimin, projektimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web profesionale, në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrjeteve kompjuterike, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike etj. GVJ konstaton se ky objektivi përmbyllet dhe rezultoni e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>DVV Evidencë 5. Rregullore e programit te studimit, Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/shkenca-kompjuterike/.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program studimi ka të grupuara qartë lëndët dhe modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe në raportin e kërkuar në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar. Plotësohet dhe kriteri që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%.</p> <p><i>DVV Evidencë 5. Rregullore e programit te studimit, Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca.</i></p>




<i>Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 10.</i>	
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p><u>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” në kurrikulën e tij nuk parashikon zhvillimin e praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese.</u> Ndërkohë ka përcaktuar ngarkesën me 6 kredite për detyrimin përmbyllës në përgjithësi si provim përfundimtar dhe në raste të veçanta si mbrojtje diplome bazuar në kriteret e miratuara nga DSHK për studentët të cilët mund të diplomohen me mbrojtje tezë diplomës (neni 35 i rregullores së programit të studimit).</p> <p><i>Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 9.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ka një plan mësimor të ngjashëm me programet e studimit në fushë mbi masën 70 %. Hapja e këtij programi është mbështetur në programe të ngjashme të fushës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>GVJ evidenton se numri i orëve totale në auditor për aktivitetet formuese, në UAMD është më i ulët se në institucionet e tjera të arsimit të lartë për programe të ngjashme studimi. Nga ku shohim se numri i orëve në auditor për këtë program studimi zë 30% të orëve totale, në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar, e cila kufizon numrin e orëve në auditor jo më shumë se 50% por nuk vendos limit të poshtëm.</p> <p><u>GVJ gjykon se numri i orëve në auditor(30 %) është jo i mjaftueshëm për këtë program studimi dhe sugjeron se duhet të jetë së paku 40% në auditor.</u></p>

	Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 9.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstaton UAMD është në proces kodifikimi të programit të studimit, në bazë të VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kodi i propozuar për programin e studimit është DR4826200957.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Ky program studimi është organizuar nga UAMD në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i> - <i>Ky program studimi ka një plan mësimor të ngjashëm me programet e studimit në fushë mbi masën 70 %. <u>GVJ gjykon se numri i orëve në auditor (30 %) është jo i mjaftueshëm për këtë program studimi dhe sugjeron se duhet të jetë së paku 40% në auditor.</u></i> - <i><u>Në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale. GVJ është i mendimit se integrimi i saj në planin mësimor do të kontribonte në një formim më cilësor.</u></i> - <i>Ky program studimi është në proces kodifikimi i programit të studimit.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 24.03.2022 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Njësitet kryesore të UAMD janë riorganizuar me VKM nr.685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës".</p> <p>Rezultoni se Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamentin e Shkencave Kompjuterike; • Departamentin e Teknologjisë së Informacionit; • Departamentin e Matematikës; <p>Përveç programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", DSHK ofron studime dhe në 10 programe, 1 program me karakter profesional, 2 të ciklit të dytë (1)MP dhe (1) Msc. Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive kryesore dhe asaj bazë që janë përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit, rregulloret specifike dhe janë në përputhje me përcaktimet ligjore. Dekani i fakultetit mban titullin akademik "Prof.As" ndërsa përgjegjësi i departamentit ka gradën shkencore, "Doktor i Shkencave".</p> <p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në vitin akademik 2022-2023, ka në përbërje të tij 73 pedagogë gjithsej, ndër të cilët, 45 janë personel akademik efektiv (PAE), dhe 28 personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2022-2023:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike: <ul style="list-style-type: none"> - 16 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; - 10 PAK, ndër të cilët 4 me tituj / grada. 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit: <ul style="list-style-type: none"> - 14 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada; - 10 PAK. 3. Departamenti i Matematikës: <ul style="list-style-type: none"> - 15 PAE, ndër të cilët 12 me tituj / grada; - 8 PAK, ndër të cilët 2 me tituj / grada. <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe Njësitet kryesore "Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit", që janë përgjegjës për programin e studimit, në vitin akademik 2022-2023 është: 26 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 12 me grada</p>




shkencore dhe 4 staf akademik me kontratë (PAK) me MSc. Raporti PAE/PAK për këtë program studimi është si:

Viti akademik	Raporti PAE/PAK
2022-2023	26 / 4
2021-2022	27 / 4
2020-2021	27 / 1

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik.

Për sa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore minimale për numrin dhe kualifikimin grada/tituj të personelit akademik, sipas përcaktimeve të parashikuara në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë”, neni 59, pika 6 ku citohet: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.

GVJ konstatoi se personeli akademik me kontratë është relativisht i kufizuar në numër dhe mbulon një ngarkesë mësimore të kufizuar. Për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa mësimore e realizuar është përballuar në masën rreth 87% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe rreth 13% nga personeli akademik me kontratë (PAK), duke qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

DVV Evidencë 1. Statuti UAMD; DVV Evidencë 9. VKM për hapjen e programit të studimit SHK; DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise se Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore e programit të studimit, Bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor në Shkenca Kompjuterike.

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore ka të angazhuar për programin e studimit, 4 personel ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore me kualifikimin Msc.

DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike – Tabelat 1 dhe 2.

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” ka caktuar këshilltarin akademik/koordinatorin e programit të studimit, që ndjek ecurinë e studentëve të këtij programi studimi, që në bashkëpunim me DSHK dhe zëvendësdekanin për anën mësimore ndjek dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit. Roli i koordinorit të programit të studimit është i përcaktuar në rregulloren e njësisë bazë.</p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD dhe DVV Evidenca 19. Vendimi per kordinatoret.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ evidenton se kriteret minimale të këtij standarti përmbushen për njësinë kryesore dhe bazë përgjegjëse për numrin dhe shkallën e kualifikimit(titujt) të personelit akademik që mbulon programin e studimit. - Ngarkesa mësimore realizohet në masën dërmuese nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi. - Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka caktuar këshilltarin akademik/koordinatorin për programin e studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e Programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike”, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të UAMD. Departamenti i Shkencave Kompjuterike, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren, programin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj.</p>

	<p>DVV Evidencë 9. VKM për hapjen e programit të studimit SHK; DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit të Teknologjise së Informacionit; DVV Evidencë 5. Rregullore e programit të studimit, Bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike; DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/shkenca-kompjuterike/ dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/SHK.pdf.</p>																														
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se veprimtaritë formuese të programit të studimit janë shpërndarë në përputhje me VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="655 759 1492 1314"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Pershkrimi</th> <th>% sipas VKM 41</th> <th>Kredite/ ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>15%-20%</td> <td>36</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50% - 55%</td> <td>96</td> <td>54%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td> <td>12% -15%</td> <td>24</td> <td>13%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese (praktika profesionale)</td> <td>10% -15 %</td> <td>18</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)</td> <td>3% - 5%</td> <td>6</td> <td>3%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit, GVJ konstaton se ky program studimi përmban 29 lëndë, nga të cilat 6 me zgjedhje dhe provimin perfundimtar/punimin e diplomës. Në çdo semester I - V janë 5 lëndë dhe në semestrin e VI-të janë 4 lëndë dhe provimi perfundimtar/punimi i diplomës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” përmban në planin mësimor informacionin e nevojshëm për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semester dhe çdo vit akademik; Numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë, si dhe orët në total për cdo lëndë në auditor/ jashtë auditorit. 	Kategoria	Pershkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%	A	Lëndë bazë	15%-20%	36	20%	B	Lëndë karakterizuese	50% - 55%	96	54%	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15%	24	13%	D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10% -15 %	18	10%	E	Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)	3% - 5%	6	3%
Kategoria	Pershkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%																											
A	Lëndë bazë	15%-20%	36	20%																											
B	Lëndë karakterizuese	50% - 55%	96	54%																											
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -15%	24	13%																											
D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10% -15 %	18	10%																											
E	Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)	3% - 5%	6	3%																											

	<p>Por nuk përmban në planin mësimor informacion i nevojshëm për:</p> <p>c) <u>ngarkesën mësimore të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyre kursi etj;</u></p> <p>d) <u>orët në auditor/ jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë dhe për çdo element të saj, gjatë një semestri.</u></p> <p><i>DVV Evidencë 5. Rregullore e programit te studimit, Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike; DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/ dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/SHK.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se rregulloret e UAMD, FTI dhe të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” përmbajnë përgjithsisht informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullorja e programit: “Kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga DSHK dhe miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MAS, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen dhe janë të aksesueshme në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të UAMD. <u>Në rastin e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, mungesa e ndarjes në kredite për secilin element të lëndëve (leksion, seminar, ushtrime, laborator etj) e vështirëson këtë proces.</u></p> <p><i>DVV Evidencë 3. Rregullore UAMD; DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit dhe DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore në total për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj, <u>por nuk jepen ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator, detyrë apo</u></p>

	<p><u>projekt kursi) dhe kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë për secilin element të lëndës. GVJ evidenton se në disa syllabuse të lëndëve të programit të studimit, titullari i lëndës mungon ose nuk ka gradën e kërkuar sipas kriterit Prof. apo Prof.As.. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve nuk janë të përcaktuara temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.</u></p> <p><i>DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike -Tabela 14.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të cdo viti akademik. Bazuar dhe në rregulloren e programit të studimit, riorganizimi i programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike (kurrikulës) propozohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe i përcillet për miratim Dekanatit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Dekanati pasi e shqyrton në detaje dhe bashkë me korrigjimet e mundshme, ja përcjell propozimin për miratim Senatit Akademik të UAMD. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. Aktualisht nuk ka ndryshime të raportuara në kurrikulën e të programit të studimit që nga viti 2018.</p> <p><i>DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike -Tabelat 9,10,11dhe 14.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Shkenca kompjuterike" disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të UAMD duke përfshirë plan programin e studimit, në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i> - <i>Në planin mësimor mungon informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyre kursi etj; orët mësimore në auditor/jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë dhe për cdo</i>

	<p><u>element të saj, gjatë një semestri, që vështrëson procesin në rastin e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Në syllabuset e lëndëve nuk paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator, detyrë apo projekt kursi), kreditet dhe orët në auditor/ jashtë auditorit për secilin element të lëndës. si dhe nuk përcaktohen temat e detyrave/projekteve të kursit dhe të punëve laboratorike.</u> - <u>GVJ rekomandon që titullarët e të gjithë lëndëve të programeve të studimit të jenë sipas kritereve ligjore me gradën Prof. dhe Prof.As.</u> - <u>GVJ rekomandon të plotësohet me elementët e munguar plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve.</u> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FTI ka një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me aktor të tregut të punës, madje me mbështetjen e tyre ka ngritur edhe laboratorë. Ndër to përmendim laboratorët e ngritur me mbështetjen e Crystal System që prej vitit 2017. Edhe në analizën vjetore, institucioni vlerëson edhe nevojat e tregut të punës, të evidentuara nga pyetëtorët, takimet e drejtëpërdrejta por edhe nga bashkëpunimet institucionale si me partnerët e biznesit ashtu edhe me ata akademik.</p> <p><u>GVJ rekomandon që DSHK duhet të kryejë një studim në tregun e punës të fushës për të përmirësuar më tej këtë program studimi për t'u përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në UAMD, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale sipas statutit dhe rregullores së UAMD. UAMD përfshin studentët në diskutimet e brendshme të njëjësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programeve që ofrohen. UAMD përdor metodat e komunikimit "sociale" midis studentëve dhe institucionit, përfshirë këtu komunikimet online në rrjete sociale të sekretarisë mësimore, të Zv. Dekanit apo edhe drejtuesve të njëjësive bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet cdo semestër para provimeve; 2. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve (ku mungojnë elementët e seminareve, laboratorëve, etj) mundëson përgatitjen e studentëve kryesisht me aftësi teorike. <u>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” në kurrikulën e tij nuk parashikon zhvillimin e praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese.</u> UAMD ka realizuar disa aktivitete për aftësimin e tyre profesional në UAMD dhe kompania Crystal System u ka mundësuar studentëve trajnime dhe certifikime në fushë.</p> <p><i>DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System; DVV Evidencë 27. Trajnime FTI - Crstal System; DVV Evidencë 31. Workshops dhe DVV Evidencë shtesë. Çertifikata të studentëve gjatë trajnimeve.</i></p>												
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se disa lëndë të rëndësishme për realizimin e objektivave dhe rezultateve të programit të studimit, në fushën e shkencave kompjuterike janë: “Baza të dhënash I dhe II”, “Inxhinieri software”, “Programim Java dhe Java i avancuar”, “Programim i Orientuar në Objekte”, “Magazinin Informacioni dhe Kërkim Njohurish”. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 6 semestrat e realizimit të programit është e balancuar me 30 kredite për çdo semestër.</p> <p>UAMD ofron për studentët disa orare frekuentimi me të njëjtin pedagog apo me pedagog të tjerë që zhvillojnë të njëjtën lëndë në të njëjtin semestër. Kjo u jep studentëve më shumë mundësi për të caktuar orarin më të përshtatshëm për frekuentim.</p>												
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Ngarkesa mësimore javore në auditor është:</p> <table data-bbox="638 1496 997 1729"> <tbody> <tr> <td>1. Semestri I</td> <td>15 orë;</td> </tr> <tr> <td>2. Semestri II</td> <td>15 orë;</td> </tr> <tr> <td>3. Semestri III</td> <td>15 orë;</td> </tr> <tr> <td>4. Semestri IV</td> <td>15 orë;</td> </tr> <tr> <td>5. Semestri V</td> <td>15 orë;</td> </tr> <tr> <td>6. Semestri VI</td> <td>12 orë;</td> </tr> </tbody> </table> <p><u>Gjatw takimi</u></p> <p><u>GVJ e kishte të pamundur të vlerësojë raportin teori-praktikë për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm në planin mësimor dhe në</u></p>	1. Semestri I	15 orë;	2. Semestri II	15 orë;	3. Semestri III	15 orë;	4. Semestri IV	15 orë;	5. Semestri V	15 orë;	6. Semestri VI	12 orë;
1. Semestri I	15 orë;												
2. Semestri II	15 orë;												
3. Semestri III	15 orë;												
4. Semestri IV	15 orë;												
5. Semestri V	15 orë;												
6. Semestri VI	12 orë;												




	<p>syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike Tabelat 9, 10 dhe 13 dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/SHK.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në këtë program studimi gjatë 3 viteve akademike zhvillohen 1350 orë mësimore në auditor, të paspecifikuara për veprimtari mësimore, si dhe 3150 orë mësimore jashtë auditorit. <u>Në planin mësimor të këtij program studimi mungon informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyre kursi etj; orët mësimore në auditor/ jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë dhe për cdo element të saj, gjatë një semestri, që vështirëson procesin dhe në rastin e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, si dhe mobilitetin e studentëve të këtij programi studimi.</u> Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve, gjatë takimit në institucion me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i lëndëve karakterizuese në ambiente të pajisur me PC, ku krahas analizës teorike, zhvillohen edhe aplikime praktike në ambientin laboratorik etj. Gjithsesi, <u>GVJ e kishte të pamundur të vlerësojë raportin teori-praktikë për shkak të mungesës së këtij informacioni në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve.</u></p> <p>Në këtë program studimi janë transferuar 6 studentë përkatësisht 1 në vitin e parë (2020-2021), 1 në vitin e 2-të (2021-2022) dhe 4 në vitin e 2-të (2022-2023). Në këtë program studimi mobiliteti nga dhe drejt programit të studimit ka qenë 10 studentë.</p> <p><i>DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabelat 9,10,11,13 dhe 14; DVV Evidenca 27 tabela 21 e azhornuar dhe DVV Evidenca 2. Te Dhena mbi mobilitetin studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabuset e programit të studimit. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. Në këtë program studimi nuk ka pasur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><u>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre, nuk është përcaktuar viti i botimit të literaturës dhe për disa të tjera nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës.</u></p>

	<i>DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabelat 9,10,11dhe 14 dhe DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike.</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit siguron përfitim e njohurive, aftësive, si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Studentë të programit të studimit kanë përfitur mobilitet dhe janë punësuar në tregun e punës. <i>DVV Evidencë 3. Rregullore UAMD; DVV Evidencë 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 22 dhe DVV Evidencë 11. Syllabus Bachelor ne Shkenca Kompjuterike.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve që kanë kërkesa nga tregu i punës. Këtë e tregon dhe punësimi i një pjesë të studentëve të këtij program gjatë periudhës së studimeve. <i>DVV Evidenca: Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 23.</i>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <u>Struktura dhe organizimi i programit të studimit kryesisht është në përputhje me objektivat formuese, përputhje me nivelin 6 të KSHK-së, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e shkencave kompjuterike.</u> - <u>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" në kurrikulën e tij nuk parashikon zhvillimin e praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese.</u> - <u>GVJ e kishte të pamundur të vlerësojë raportin teori-praktikë për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve.</u> - <u>Në këtë program studimi nuk ka pasur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit.</u> - <u>Nga vlerësimi i literaturës së lëndëve, në syllabuse, konstatohet që për një pjesë të tyre, nuk është përcaktuar viti i botimit dhe për disa të tjera nuk është e 5 viteve të fundit sipas kriterit përkatës. GVJ rekomandon që të azhurnohet literature në syllabuset e lëndëve, pasi duhet të jetë e 5 viteve të fundit.</u> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p><i>DVV Evidenca shitesë. Lista e marreveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK; DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System; DVV Evidenca: Formulari i vleresimit të stafi akademik nga studentet-final; DVV Evidence mbi informimin e lektoreve mbi rezultatin e vleresimit të studenteve; DVV Evidencë 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ); DVV Evidenca: Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 24 dhe DVV Evidencë 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</i></p>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ evidenton se në IAL, njësitë përgjegjëse angazhohen në përfshirjen e studentëve dhe bashkëpunëtorëve në përmirësimin e programit të studimit.</i> - <i>GVJ rekomandon që DSHK duhet të kryejë një studim në tregun e punës të fushës për të përmirësuar më tej këtë program studimi për tju përshatur kërkesave dhe nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UAMD, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes mësimin të integruar, të cilat janë përcaktuar në rregulloren e FTI (leksion, seminarë dhe punë laboratorike), por duhet plotësuar dhe saktësuar në planin mësimor dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>syllabuset e lëndëve. Personeli akademik është mbështetur nga IAL në rritjen akademike dhe profesionale dhe është udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i>DVV Evidencë 3. Rregullore UAMD; DVV Evidencë 4. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit; DVV Evidenca 6. Vertetim Dokt process; DVV Evidenca 25. Aktivitete te stafit Leksione te hapur dhe DVV Evidenca 14. Mesim online.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. IAL ka inkurajuar dhe mbështetur stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnuese, leksione të hapura dhe workshope, si dhe exchange për rritjen e kapaciteteve të tyre. Pjesa më e madhe e personelit akademik është i angazhuar me kohë të plotë dhe me një ekperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit i mundësojnë personelit akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Procesi i kompetencës së mësimdhënies mbështetet në këto etapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Stafit akademik që aplikon për t'u angazhuar në mësimdhënie rekrutohet nëpërmjet një proces vlerësimi në bazë të kriterëve dhe dokumentacionit përkatës të ekspertizës dhe përvojës së aplikantit në fushë. 2. Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit UAMD inkurajon, mbështet rritjen profesionale të stafit akademik. <p>Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale.</p> <p><i>Evidencë 12. CV e stafit akademik të SHK; DVV Evidenca 6. Vertetim Dokt process; DVV Evidenca 25. Aktivitete te stafit Leksione te hapura; DVV Evidenca 2. Raportimi i ndermjetem per Projektin Kerkimor shkencore;</i></p> <p><i>DVV Evidenca 14. Mesim online; DVV Evidenca shitesë. Lista e marreveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK dhe DVV Evidencë 24. Analize e Departamentit të Shkencave Kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe</p>	<p>Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu. UAMD ka</p>

<p>përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, që janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njërive kryesore dhe bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet çdo semestër para provimeve; 2. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. <p><i>DVV Evidenca shtesë. Lista e marreveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK; DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System; DVV Evidenca: Formulari i vleresimit te stafi akademik nga studentet-final; DVV Evidenca shtesë. Mbi informimin e lektoreve mbi rezultatin e vleresimit te studenteve; DVV Evidencë 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ); DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike, Tabela 24 dhe DVV Evidencë 6. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NJSBC. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektoreve të lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetësor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen individualisht personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit.</p>

	<i>DVV Evidencë 6. Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca 25. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim; DVV Evidenca shtesë. Formulari i vleresimit të stafi akademik nga studentet-final; DVV Evidence shtesë. Mbi informimin e lektoreve mbi rezultatin e vleresimit të studenteve; DVV Evidencë 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ); DVV Evidenca 7. Memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar dhe DVV Evidenca shtesë. Kalendari plan veprimit SKSC Kurrikula dhe Sigurimi i Cilësisë.</i>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike. - UAMD angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. DKSH vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve. - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në UAMD organizon, drejton dhe monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional dhe organizojnë dhe trajnime në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimore. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD, në veçanti neni 68, Kontrolli i Dijeve, Neni 69, Zhvillimi i Provimeve, Neni 70, Rregullat e provimit dhe neni 71, Ankimimi i provimeve. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare e çdo lënde është rezultat i kombinimit në masën 400 pikë provimi i parë i ndërmjetëm, 500 pikë provimi përfundimtar dhe 100 pikë përfshijnë vlerësimin e pjesëmarrjes, detyrave të kursit. Megjithatë ka dhe duhen saktësuar mospërputhjet në tabelën e vlerësimit me notë kundrejt pikëve të fituara nga studenti gjatë testimit të njohurive, në rregulloret e UAMD,

	<p>syllabuse dhe suplementit të diplomës. <u>GVJ sugjeron që informacione që janë të pandryshueshme për një kohë të konsiderueshme, si tabela e konvertimit, të vendosen vetëm në rregulloren institucionale, dhe të referohen në të gjithë aktet rregullatore / dokumentat e tjerë ku është i nevojshëm informacioni.</u></p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se DSHK për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit të studimit, si dhe informacione që studentët marrin edhe nga rrjetet sociale që menaxhohen në mënyrë zyrtare nga UAMD. Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve. I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit disponohet nga njësia bazë, publikohet në faqen zyrtare UAMD dhe në faqet e UAMD në rrjetet sociale.</p> <p>DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve ne Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca 24. Analize e Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/shkenca-kompjuterike/.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [0-400] pikë, pjesëmarrja në seminare, detyrë kursi [0-100 pikë], provimi përfundimtar [0-500] pikë.</p> <p>DVV Evidenca 23. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve ne Shkenca Kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Më tej këto vlerësime u bëhen të njohura personelit akademik, individualisht dhe analizohen nga</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>njësia bazë dhe rezultatet e kësaj analize përdoren për përmirësimin në vazhdim të formave dhe metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>DVV Evidenca 24. Analize e Departamentit të Shkencave Kompjuterike; DVV Evidenca 23. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>DVV Evidenca 28. Pyetësor Student UAMD dhe DVV Evidenca 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Studentët në veçanti në lëndët karakterizuese të këtij programi studimi, motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedagogut të lëndës dhe studentëve të tjerë. Kjo mundëson zhvillimin e autonomisë së studentit i cili jo vetëm përvetëson njohuritë, por mëson edhe ti përçojë ato. Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca kompjuterike” posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe specialist të fushës me eksperiencë në industri dhe administratë publike, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperienca e tyre është me vlerë në mbështetjen dhe demonstrimin në auditor të rasteve reale të zbatimit të lidhura me fushën e studimit të shkencave kompjuterike.</p> <p><i>DVV Evidenca 26. Liste MoU; DVV Evidenca 22. Memorandum UAMD - Crystal System; DVV Evidenca 28. Trajnime FTI - Crstal System dhe DVV Evidenca 25. Aktivitete te stafit Leksione te hapura.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD. <u>GVJ sugjeron që informacione që janë të pandryshueshme për një kohë të konsiderueshme, si tabela e konvertimit, të vendosen vetëm në rregulloren institucionale, dhe të referohen në të gjithë aktet rregullatore / dokumentat e tjerë ku është i nevojshëm informacioni.</u></i> - <i>Syllabuset e lëndëve ju vihen në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës/modulit në javën e parë të mësimit.</i> - <i>Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren e UAMD , rregulloren e FTI dhe rregulloren e programit të studimit, në procedurat e vlerësimit të studentëve në funksion të përmbushjes së detyrimeve akademike dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie, sipas kriterëve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm [0-400] pikë, Niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra kursi [0-100] pikë, Provimit përfundimtar [0-500] pikë. Këto forma vlerësimi u japin mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë dhe talentet e tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD. DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në UAMD realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe ato me gojë), si dhe format elektronike si hartimi, dërgimi elektronik dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Për disa kurrikula specifike në UAMD është përdorur dhe metoda elektronike e vlerësimit nëpërmjet projektit Cleanscore me Fondi Shqiptaro - Amerikan i Zhvillimit (jo i përshtatshëm për këtë program studimi).</p> <p><i>DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve ne Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca shitesë. Marreveshje Clean Score.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara në rregulloret UAMD, FTI dhe të programit të studimit, si dhe në syllabusin përkatës të lëndës. Në të njëjtën kohë u bëhet e ditur studentëve në javën e parë mësimore nga pedagogu i lëndës.</p>




	<p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të lëndës stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Korigjimi i provimit shoqërohet me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe arsyetimin e vlerësimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua që në rastet e nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.</p> <p>DVV Evidenca 3: Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4: Rregullore FTI; DVV Evidenca 5: Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11: Syllabuset e lëndëve SHK.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloren e UAMD është e përcaktuar moslejimi dhe janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që të shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.</p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloret e UAMD, FTI dhe programit të studimit, si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore që vlerësimi kryhet me sistem prej 1000 pikësh i përkthyer në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve pedagogu i lëndës në orën dhe sallën e dakordësuar paraprakisht me studentët. Gjatë vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, quiz-e, prezantime në grup ose individuale, etj.</p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të informuar mbi të drejtën e tyre për ankimim, kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e UAMD. Me shpalljen e rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Pas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimit/pedagogu i lëndës të cilët vendosin për notën përfundimtare. Në rastet e vazhdimit të kontestimit të vlerësimit/notës studenti ka të drejtën e kontestimit duke iu drejtuar me kërkesë Dekanit të FTI, i cili pasi shqyrton kërkesën, në rast se pranohet, kërkesa analizohet nga një komision ad-hoc i ngritur me pedagog të lidhur me disiplinën që po vlerësohet (jo pedagogu i lëndës). Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo sqaronin çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre.</p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4: Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në rregullore, procedura dhe kriteret specifikë, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit në çdo rast të kërkuar, të cilat u bëhen të njohura studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në programimin, zbatimin e aplikacioneve, komunikimin, menaxhimin e bazave të të dhënave, zhvillimin e softwareve, zhvillimin e website-ve, mediat dixhitale dhe publikimet elektronike, etj. Në të njëjtën synojnë të aftësojnë studentët në planifikimin, projektimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web profesionale, në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrjeteve kompjuterike, zbatimin e aplikacioneve të internetit për tregti elektronike etj. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë karakteristike në fushën e shkencave kompjuterike si dhe përmbyllet me punimin e diplomës. Në këtë program studimi nuk është parashikuar lënda "Praktikë Profesionale", e cila do të ndihmonte studentin të vinte në praktikë njohuritë e përftuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës. DSHK mundëson për studentët krahas procesit mësimor, procesin e konsultimeve dhe leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikul përgatit studentët për thellimin e studimeve në ciklin master. <u>Nga shqyrtimi i plan-programeve të lëndëve vërehet se nuk janë parashikuar qartë orët laboratorike dhe ato të ushtrimeve, të cilat sipas UAMD janë të përfshira në ngarkesën e orëve totale në auditor në atë që e quajmë "orë të integruara".</u></p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike; DVV Evidencë 26. Plani mesimor SHK dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike dhe në fushën e teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe ndërveprimit dhe aftësi të tjera të vecanta kurrikulare si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëndë për aftësimin në gjuhë të huaj (Anglishte teknike); • lëndë për aftësimin logjik (Llogjika Dixhitale); • Lëndë në teknologjinë e informacionit (Hyrje në Sistemet e Informacionit, TIK dhe Inovacion etj); • lëndë për aftësi menaxhuese (Hyrje në ekonomi, Sociologji, Baza e menaxhimit, Komunukimi në Publik) etj.




	<p><i>DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike; DVV Evidencë 26. Plani mesimor SHK dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Metodot e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale ju bëhen të njohura studentëve, analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u vihen në vëmendje konceptet dhe çështjet më të rëndësishme, si dhe të orientohen studentët për aplikimin e tyre, si dhe detyrimet përmbyllëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuara në syllabuset e lëndëve. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se nga ana e tyre në mënyrë të vazhdueshme mbështeten, orientohen dhe udhëzohen studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Gjithashtu në javët e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentët mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p> <p><i>DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</i></p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i lëndëve karakterizuese në ambiente të pajisur me PC, ku krahas analizës teorike, zhvillohen edhe aplikime praktike në ambientin laboratorik etj. Edhe nga stafi akademik u informuam se zhvillimi i seancave laboratorike janë të gërshetuara me ato teorike (Leksione, seminare/ushtime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik. Stafi akademik i njësisë bazë është angazhuar në disa aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë UAMD. Stafi akademik i DSHK organizon diskutime me studentet për temat e diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. Në këtë program studimi mobiliteti nga dhe drejt programit të studimit ka qenë 10 studentë.</p> <p><i>DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2021-2022 SKS; DVV Evidenca. Lista e marreveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK; DVV Evidencë 22. Memorandum UAMD - Crystal System; DVV Evidenca 2. Te Dhena mbi mobilitetin studenteve; DVV Evidenca shtesë 2. Raportimi i ndermjetem per Projektin Kerkimor shkencore dhe DVV Evidenca 9. Konferenca CALL FTI.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe njësia kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizojnë në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e tyre. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.</p> <p><i>DVV Evidenca 31. Workshops; DVV Evidenca shtesë 8. workshop studentore FTI; DVV Evidenca 25. Aktivitete te stafit Leksione te hapura dhe DVV Evidenca shtesë. Lista e marreveshjeve MSH SHKA BACHELOR SHK.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>- GVJ konstaton se njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përmbushjen e objektivave personale.</p>

	<p>- UAMD ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>- DSHK ka organizuar leksione të hapura, workshope dhe seminare mbi zhvillimet e fundit në fushë dhe jashtë strukturës së programit të studimit nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në aktet e brendshme rregullatore, në rregulloret e UAMD dhe FTI paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë dhe në këtë program studimi. Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” jepet procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit. UAMD ka hartuar kërkesat e diplomimit që i bëhen të ditura studentit nga DSHK. Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Staf i brendshëm akademik i DSHK përgatit dhe informon studentët për tematikat për punimet e diplomave, së bashku me udhëzimet e përgatitjes së punimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>DSHK harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar të diplomimit, të cilat u vihen në dispozicion studentëve nga zyra e informimit pranë njësisë kryesore. Gjithashtu, për studentët që plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të përvitshëm të dekanatit diplomohen me një punim diplome, DSHK përcakton stafin akademik për udhëheqjen e diplomave, të cilët kanë rol kyç në mentorimin, kontrollin dhe vlerësimin e ecurisë së punimit deri në diplomim të studentit.</p>



	DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstaton se në rregulloren e UAMD përcaktohet se teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në programin e studimit dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, duke ruajtur përqindjen e përcaktuar. DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	DSHK ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e diplomave përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është udhëheqësi i diplomës, i cili ka rol këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës, por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik. Udhëheqësit e punimit të diplomës udhëzojnë studentët në procesin e kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të punimit, garantimin e cilësisë së punimit dhe rezultateve, si dhe miratimin e punimit final të diplomës për tu prezantuar para komisionit të diplomimit. Mbështetja e UMAD përfshin edhe vënien në dispozicion të studentit ambientet laboratorike dhe fondin e bibliotekës fizike, dhe bazuar edhe në programet e ndryshme të studimit që ofrohen. Biblioteka është hapur edhe në fundjavë për ta bërë atë të aksesueshme maksimalisht për studentët.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë, që pasqyron performancën e tyre kërkimore e shkencore në punimin e diplomës. DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca kompjuterike
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga	Bazuar në dokumentacionin e DVV, GVJ konstaton se UAMD ka të miratuar modelin e diplomës me numër unik DR4826200957 nga QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore). Studenti pajiset me diplomën dhe

ministra përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	suplementin e saj. UAMD përgatit dy herë në vit diplomat për studentët e diplomuar, në sezonin e dimrit dhe në atë të vjeshtës. DVV Evidenca 10. Modeli i diplomës SHK (Urdhëri i aprovimit) dhe Suplementi			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për procesin mësimor të çdo viti akademik, që arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Në rastet kur studenti pas diplomimit kërkon, ai mund të pajiset me dublikata të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni. DVV Evidenca 1. Statuti UAMD DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UAMD ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të provimit të përgjithshëm përfundimtar /diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm pas diplomimit, i cili arkivohet sipas rregullores së IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit,	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriteri i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program

<p>përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>studimi. DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike.</p> <table border="1" data-bbox="646 224 1508 638"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>8</td> <td>-</td> <td>9</td> <td>-</td> <td>8</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>15</td> <td>1</td> <td>14</td> <td>1</td> <td>16</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>27</td> <td>1</td> <td>27</td> <td>4</td> <td>26</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</p> <p>DVV Evidenca 14. CV e stafit akademik të SHK.</p>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	4	-	4	-	2	-	Dr/Phd	8	-	9	-	8	-	Msc.	15	1	14	1	16	4	Gjithsej	27	1	27	4	26	4
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	4	-	4	-	2	-																																											
Dr/Phd	8	-	9	-	8	-																																											
Msc.	15	1	14	1	16	4																																											
Gjithsej	27	1	27	4	26	4																																											
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik me kontratë është relativisht i kufizuar në numër. Në këtë mënyrë dhe ngarkesa mësimore e mbuluar prej tij është e kufizuar. Për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa mësimore e realizuar është përballuar në masën rreth 87% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe rreth 13% nga personeli akademik me kontratë(PAK), duke qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike.</p>																																																
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar tabelave përmbledhëse në DVV si dhe nga verifikimet gjatë vizitës në institucion rezulton se në vitet e fundit ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Si institucion publik, UAMD garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore ose semestrale</p> <p>DVV Evidenca. Takime në sektorin e Burimeve Njerëzore.</p>																																																
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UAMD. Në statut dhe në rregullore përcaktohet se departamentet, bazuar në analizën</p>																																																




<p>kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>e nevojave të tyre, përcaktojnë kriteret specifike për vendet e punës, të cilat miratohen nga Rektori. Procedura e rekrutimit, ndërmjet të tjerave, përcakton krijimin e një komisioni <i>ad hoc</i> nga ana e ana e drejtuesit të njësisë kryesore për përzgjedhjen e kandidatëve fitues të përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se tre janë përfaqësues të njësisë bazë. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme që janë vlerësimi i dosjes (që ka 70% të peshës) dhe intervista (me 30 % të peshës në vlerësimin final). Drejtuesi i njësisë kryesore i paraqet Rektorit renditjen e kandidatëve sipas vendimit të komisionit dhe Rektori lidh kontratën me kandidatin e përzgjedhur. Kontrata përmban përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimet e personelit sipas legjislacionit në fuqi. GVJ u njoh edhe me procedurën e rekrutimit të stafit akademik gjatë vizitës së kryer pranë sektorit të Burimeve Njerëzore. Në verifikimet e kryera GVJ konstaton zbatimin korrekt të procedurës së vendosjes së kriterëve të veçanta në procesin e punësimit të stafit akademik.</p> <p><i>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca. Takime në sektorin e Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në strukturën e FTI aktualisht janë gjashtë personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar. Nga shqyrtimi i CV të personelit ndihmës-akademik që kontribuon në realizimin e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", GVJ konstaton se kemi të bëjmë me personel ndihmës-akademik me kualifikim në fushën e informatikës apo teknologjisë së informacionit në nivelin Master i Shkencave apo Master Profesional. Në këtë mënyrë disponohet niveli i duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për kontributin nga ana e këtij personeli në instalimin e programeve informatike, mirëmbajtjen e laboratorëve etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 14. CV e stafit ndihmës akademik SHK dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna</p>	<p>UAMD ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore dhe zyrën e Arkiv-Protokollit, të cilat janë përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ. GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore e cila ka në përbërje 5 specialistë (nga një për çdo fakultet). GVJ konstatoi se kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik. Përsa i përket informacionit në lidhje me angazhimin e çdo anëtari të</p>

<p>përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>personelit akademik dhe ndihmës akademik në çdo semestër dhe vit akademik, ky informacion administrohet nga FTI si dhe nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe DVV Evidenca. RVB.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktika profesionale nuk është pjesë e syllabusit të këtij programi studimi. Elementë praktikë të përvehtësisë të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës (për studentët që diplomohen me temë diplome).</p> <p><i>DVV Evidenca 26. Plani mesimor SHK ; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Takime në institucion].</i></p> <p>GVJ është i mendimit se integrimi në planin mesimor i praktikës profesionale si element i veçantë do të kontribonte në një formim më cilësor të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale.</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Personeli akademik i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mesimor si dhe fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve ;</i> - <i>Ngarkesa mesimore realizohet në masën dërmuese nga personeli akademik efektiv duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi;</i> - <i>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UAMD;</i>



	- <u>Në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale, por GVJ është i mendimit se integrimi i saj në planin mësimor do të kontribonte në një formim më cilësor.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UAMD zhvillon aktivitetin në dy godina: Godina Qendrore (Currila) me sipërfaqe 6000 m ² dhe Kampusi Spitalë me dy godina (me sipërfaqe rreth 20000 m ²). Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", i cili mbulohet nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, realizohet në Godinën Qendrore (Currila) dhe për realizimin e procesit mësimor janë vënë në dispozicion ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seancave laboratorike. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GVJ konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me paisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. <i>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/kampusi/; DVV Evidenca 29. Laborator FTI ; DVV Evidenca 10. Relacion Lab 015 101 111 211 dhe DVV Evidenca Vizitë e ambienteve në FTI.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	FTI zotëron 3 laboratorë programimi (sallat 101, 111 dhe 211) të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili, 2 laboratorë të profilit të multimedias (sallat 103 dhe 203), një laborator kërkimor (salla 015) dhe VTech Hub (401). Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj.

	<i>DVV Evidenca 29. Laborator FTI ; DVV Evidenca 10. Relacion Lab 015 101 111 211; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Vizitë e ambienteve në FTI.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GVJ konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi dhe FTI në veçanti i është kushtuar një vëmendje e veçantë paisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të programit. Kjo infrastrukturë informatike është e mbështetur dhe nga sisteme shfrytëzimi dhe programe kompjuterike që i korrespondojnë nevojave të zhvillimit të lëndëve të parashikuara në programin mësimor. Karakteristikat e harduerit si dhe të programeve të karakterit të përgjithshëm dhe profesional të pranishëm në laboratorët përkatës janë në përputhje me kërkesat për realizimin bashkëkohor të elementëve të programit. GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me këta elementë. GVJ është i mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. <i>DVV Evidenca 29. Laborator FTI; DVV Evidenca 10. Relacion Lab 015 101 111 211 dhe DVV Evidenca. Vizitë e ambienteve në FTI.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të paisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i paisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur. <i>DVV Evidenca 29. Laborator FTI; DVV Evidenca 10. Relacion Lab 015 101 111 211; DVV Evidenca 14. CV e stafit ndihmës akademik SHK dhe DVV Evidenca. Vizitë e ambienteve në FTI.</i>
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me paisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i> - <i>Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</i>

	- Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i paisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
<p>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime me studentë e pedagogë dhe DVV Evidenca. RVB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seanceve praktike të rejtat që lidhen me lëndët përkatëse. Pasqyrimi i përditësimit të literaturës së rekomanduar pasqyrohet në syllabus nga personeli akademik përgjegjës për lëndën dhe miratohet çdo fillim semestri në departament. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve vënë në dispozicion nëpërmjet DVV, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime me studentë e pedagogë; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca 11. Syllabuset e lëndëve SHK.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Biblioteka e UAMD, krijuar në fund të vitit 2007, ka aktualisht në fondin e saj rreth 12000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Fondi shqip dhe i huaj mbulon të gjithë fakultetet e universitetit. Literatura është bashkëkohore, kryesisht shkencore me moshë mesatare 5-10 vjeçare. <i>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/.</i> Biblioteka ka tri vendndodhje nga të cilat në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Godinën Universitare në Currila mbulon Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se studentët e programit të studimit kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike, çdo ditë, në orarin 8:00 - 16:00. Gjithashtu studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe bibliotekën on-line, rregjistrimi në të cilën realizohet nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i>.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime me studentët; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/ dhe DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka në Godinën Universitare në Currila e cila mbulon Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit është e paisur me fond fizik që mbulon literaturën bazë të programit të studimit (në shqip dhe në gjuhë të huaj). Megjithatë, nga takimi me studentët, rezulton se biblioteka fizike shfrytëzohet shumë pak prej tyre. Studentët preferojnë më tepër të shfrytëzojnë bibliotekën on-line. Për vetë natyrën e programit të studimit është e mundur nëpërmjet bibliotekës on-line dhe internetit të sigurohet akses në një literaturë të gjerë dhe e përditësuar në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze dhe studentët preferojnë këtë opsion.</p> <p><i>DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë; DVV Evidenca. Takime me studentët dhe DVV Evidenca 8. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike: Neni 31.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ofron edhe U-library <i>DVV Evidenca. https://ulibrary.rash.al</i> pjesë e rrjetit të IAL-ve publike mundësuar nga Rrjeti Akademik shqiptar.</p> <p>UAMD ka akses edhe në bibliotekën digjitale JSTOR e cila ofron më se 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik. <i>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</i>. Gjithashtu, biblioteka e UAMD është bërë pjesë e Programit Cobiss, duke mundësuar në këtë mënyrë qasje online në një numër të madh bazash të dhënash të bibliotekave të ndryshme.</p> <p><i>DVV Evidenca. https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search ; DVV Evidenca. https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/libraries dhe DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjuter të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar në këtë mënyrë dhe aksesimin në bibliotekat online të cilat institucioni ka abonime. Gjithashtu studentët kanë</p>




<p>teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>mundësinë të aksesojnë bibliotekën online nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i> (nëpërmjet të cilit bëjnë dhe regjistrimin në bibliotekën online).</p> <p>DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë dhe DVV Evidenca. Takim me studentët.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës në orarin 8:00 deri 16:00. Salla është komode dhe me kushte të përshtatshme për të punuar në ambientet e saj. Gjithashtu Shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik) ofrohet në orarin 8:00-20:00, nga e hënë në të diel.</p> <p>DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton përpjekje të institucionit dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike në veçanti për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literatura të përditësuar, element ky shumë i nevojshëm për fushën e shkencave kompjuterike ku zhvillimet janë shumë të shpejta. Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, Biblioteka Universitare, në shtator 2014, instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.</p> <p>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. Vizita në bibliotekë dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/.</p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj; - Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës në orarin 8:00 deri 16:00; - Ka përpjekje për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik;




	- Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelitë akademik në një literaturë të përditësuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në UAMD garantohet nga rregulloret përkatëse [Ev. Rregullore UAMD; Rregullore FTI]. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Përsa i përket menaxhimit të informatizuar të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, kjo sigurohet nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i>. Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e financës për verifikimin e pagesave.</p> <p><i>DVV Evidenca.</i> https://uamd.pitagora.rash.al/login; <i>DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. Vizita në institucion; DVV Evidenca.</i> https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi <i>Pitagora</i> i zhvilluar nga RASH ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. <i>DVV Evidenca.</i> https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/. Megjithatë, GVJ është i mendimit se akoma nuk kemi të bëjmë me një sistem informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aksesi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. - Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera. - <p>DVV Evidenca. Vizita në institucion; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/pitagora/ dhe DVV Evidenca. https://uamd.pitagora.rash.al/login.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga GVJ u konstatua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimit, ashtu edhe jashtë saj. Përveç sistemit <i>Pitagora</i>, nga ana e stafit akademik dhe studentëve përdoren gjerësisht edhe platforma të tilla si <i>Google Classroom</i> dhe <i>MS Teams</i>. Përdorimi i këtyre platformave mundëson transmetimin nga ana e pedagogëve të leksioneve, materialeve që lidhen me kërkesat e detyrave të kursit, zhvillimin e seancave laboratorike etj., si dhe postimin nga ana e studentëve të zgjidhjeve dhe realizimit të detyrimeve përkatëse.</p> <p>Informacione të detajuara për aktivitete të ndryshme, kuadrin ligjor, kërkimin shkencor, vendime të Senatit akademik dhe Rektoratit, transparencën, shërbime që ofrohen etj. jepen dhe në faqen web të UAMD.</p> <p>DVV Evidenca. Takim me pedagogët e programit; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/lajmet/ dhe DVV Evidenca. Mbi realizimin e mesimdhënies ne klasat virtuale <i>Google Classroom</i>]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Sistemi <i>Pitagora</i> mundëson hyrje të dedikuar të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë platformat <i>Google Classroom</i> dhe <i>MS Teams</i> dhe faqja zyrtare e UAMD ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Por, GVJ</p>

<p>dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>është i mendimit se në stadin aktual sistemi Pitagora garanton në një masë të madhe monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësimin e raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Çdo përdorues për sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FTI/UAMD.</p> <p>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/ dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/departamenti-i-shkencave-kompjuterike/.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të dhënat për programin Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" publikohen në faqen zyrtare të UAMD në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. Në këtë faqe gjendet informacion i përditësuar edhe për personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme. Informacioni në faqen web ofrohet në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe italisht.</p> <p>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/shkenca-kompjuterike/; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/SHK.pdf dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore dhe menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit Pitagora; - Sistemi Pitagora ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara; - Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar - Informacionet për programin Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" publikohen në tre gjuhë në faqen zyrtare të UAMD në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet nga Administratori i FTI, ndërsa në nivel institucioni nga Administratori i UAMD dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik dhe Rektorin e UAMD. Buxheti i UAMD-së alokohet sipas Njësive Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. <i>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i> GVJ konstatoi se nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UAMD. <i>DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit.</i> GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p>															
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Neni 96 në Statutin e UAMD përcakton edhe burimet e financimit të institucionit. Burimet kryesore të financimit për këtë program studimi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Buxheti i Shtetit; Pagesat e studentëve për arsimim; Të ardhurat për shërbimet e kryera; Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; Veprimtari kërkimore – shkencore; Projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. <p>Në mënyrë të detajuar kontributi i secilit nga burimet e financimit paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="662 1534 1460 1843"> <thead> <tr> <th data-bbox="662 1534 957 1601" rowspan="2">Të ardhurat</th> <th data-bbox="957 1534 1117 1601">2022</th> <th data-bbox="1117 1534 1300 1601">2021</th> <th data-bbox="1300 1534 1460 1601">2020</th> </tr> <tr> <th data-bbox="957 1601 1117 1646">%</th> <th data-bbox="1117 1601 1300 1646">%</th> <th data-bbox="1300 1601 1460 1646">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="662 1646 957 1747">Pushteti qëndror/ vendor</td> <td data-bbox="957 1646 1117 1747">82.40</td> <td data-bbox="1117 1646 1300 1747">75.87</td> <td data-bbox="1300 1646 1460 1747">83.39</td> </tr> <tr> <td data-bbox="662 1747 957 1843">Grantet për kërkim dhe kontratat</td> <td data-bbox="957 1747 1117 1843">0.72</td> <td data-bbox="1117 1747 1300 1843">0.28</td> <td data-bbox="1300 1747 1460 1843">0.19</td> </tr> </tbody> </table>	Të ardhurat	2022	2021	2020	%	%	%	Pushteti qëndror/ vendor	82.40	75.87	83.39	Grantet për kërkim dhe kontratat	0.72	0.28	0.19
Të ardhurat	2022		2021	2020												
	%	%	%													
Pushteti qëndror/ vendor	82.40	75.87	83.39													
Grantet për kërkim dhe kontratat	0.72	0.28	0.19													




	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	16.41	23.25	15.77
	Sponsorizimet	0.30	0.45	0.63
	Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0.06	0.03	0.01
	Shuma	100	100	100
	<p>GVJ konstaton se pjesa dërmuese e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje në veçanti për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat.</p> <p><i>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD dhe DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike (Tabela 18).</i></p>			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<p>Analiza financiare dhe realizimi i zërave të investimit dhe shpenzimet është subjekt i kontroleve periodike nga Administratori i institucionit dhe sektori i Administrimit Financiar. Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të UAMD dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD.</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", krahas analizave për problematika të caktuara që lidhen me programin e studimit, kryen dhe analiza vjetore në të cilat pasqyrohen në mënyrë të detajuar si aktiviteti kërkimor dhe në mbështetje të institucionit i stafit ashtu dhe realizimi i ngarkesës mësimore dhe analiza e detajuar e saj.</p> <p>Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njëjësive kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.</p> <p><i>DVV Evidenca 7. memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>			

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UAMD rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht financimin nga buxheti i shtetit, të ardhurat nga studentët etj.) për të realizuar objektivat e tij. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë në këtë program studimi paraqet qëndrueshmëri në tre vitet e fundit (rreth 90 studentë/vit), duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme edhe nëpërmjet tarifave për dhe gjatë shkollimit.</p> <p>DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike (Tabela 21).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - UAMD rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (kryesisht financimin nga buxheti i shtetit, të ardhurat nga studentët etj.) për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"; - GVJ konstaton se pjesa dërmuese e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje në veçanti për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat; - GVJ konstaton se nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit; - Duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UAMD GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1




Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UAMD, Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FTI dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FTI zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><i>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga FTI janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia sigurohet nëpërmjet përcaktimit të rregulloreve e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse</p> <p><i>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës</p>	<p>Përcaktimi i kriterëve pranuese të programin Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program studimi (DSHK, FTI, Rektorat, Senat akademik, MAS) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në portalin U-Albania për të gjithë maturantët. Renditja e studentëve të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" realizohet duke marrë në konsideratë me 50% peshën e mesatares sipas VKM dhe 50% peshën e mesatares së gruplëndëve</p>

shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.

matematikë. Në rregulloren e programit të studimit parashikohet edhe pranimi i kandidatëve të huaj. Nga shqyrtimi i kuotave të propozuara të vitit akademik 2022-2023, shihet se në totalin e 100 kuotave, 90 janë për shqiptarë brenda vendit, 2 për studentë që aplikojnë për program të dytë, 2 për studentë që aplikojnë për transferim studimesh, 3 kuota për shqiptarë nga trojet dhe 3 kuota për kategori të veçanta.

Për tre vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" kanë qenë si vijon:

Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2020-2021	92	1 (viti I)	93
2021-2022	88	1 (viti II)	89
2022-2023	90	4 (viti II)	94

GVJ është i mendimit se ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve. Vihet re se ka qëndrueshmëri përsa i përket numrit të studentëve të regjistruar në këtë program.

DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca 33. Vendim Senati për Kuotat; DVV Evidenca .<https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/>; DVV Evidenca.

<https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf> dhe DVV Evidenca shtesë. Tabela 21 e azhurnuar.

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve dhe procedurave japin faqja web e institucionit (kryesisht për pranimet, ofertën akademike, një tablo të përgjithshme të UAMD etj.) si dhe për një numër elementësh që lidhen me jetën studentore. GVJ është i mendimit se kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

DVV Evidenca. <https://uamd.edu.al/>; DVV Evidenca 33. Vendim Senati për Kuotat; DVV Evidenca. <https://uamd.edu.al/kriteret-e->

	<p><i>pranimit/ dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" .</p> <p><i>DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kanë të drejtë të kandidojnë për pranim në programin e studimit bachelor në "Shkenca Kompjuterike" kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM; b) kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj; c) shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe; d) si dhe personat që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe aplikojnë për program të dytë studimi. <p>Referuar kuotave të propozuara, për vitin akademik 2022-2023, shihet se në totalin e 100 kuotave, ndërmjet të tjerave ka dhe 3 kuota për kategori të veçanta. Komisioni <i>ad-hoc</i> që ngrihet nga Përgjegjësi i DSHK vendos rregullat materiale dhe procedurale që do të zbatohet për realizimin e procesit konkret të pranimeve.</p> <p>Në faqen web të UAMD publikohen kriteret për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave romë dhe egjiptiane. Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, GVJ konstaton se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në mënyrë rigorozë gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të UAMD (Statut, Rregullore).</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 33. Vendim Senati për Kuotat; DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca</i></p>

	<p>3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkencë Kompjuterike dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në faqen web të UAMD publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Në mënyrë të veçantë këto kriteret kanë të bëjnë me kandidatët nga republika e Kosovës, kandidatë me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.</p> <p>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion dhe RVB, UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Aktualisht në programet e studimit të ofruara nga FTI janë 82 studentë që përfitojnë bursa nga këto politika.</p> <p>DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. RVB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Veprimtaria e FTI zhvillohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</i> - <i>Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</i> - <i>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatën Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</i> - <i>Në faqen web të UAMD publikohen kriteret për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave romë dhe egjiptiane.</i> - <i>Në faqen web të UAMD publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera (kryesisht nga trojet shqiptare).</i> <p><i>UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. GVJ evidentoi që burimet bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e UAMD; Rregullorja e FTI) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Në të jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimorë, organizimi i grupeve mësimore, procesi i regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë semestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve, rregullat e provimit, ankimimi i provimeve, organizimi i kurseve intensive (për ndjekjen me frekuentim intensiv 2-3 javor të lëndëve të caktuara), përmirësimi i notës, mbrojtja e diplomës, organizimi dhe vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës etj.</p> <p><i>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 5. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FTI. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. Referuar rregullores së programit të studimit dhe nga takimet në institucion, GVJ u informua se për studentët të cilët përfitojnë mobilitete jashtë vendit, në se ata fitojnë kredite në institucionet pritëse, këto kredite mund t'ju njihen edhe në UAMD.</p>




	<i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ u informua se në javën e parë të semestrit organizohen ditë informuese me studentët e vitit të parë ku studentët njihen me një numër elementësh të cilët kanë të bëjnë me jetën studentore në UAMD përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse. <i>DVV Evidenca RVB; Takime në institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion, gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmbyllëse. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Studentët të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të FTI, “Kërkesën për tu regjistruar në Provimin / Temën e Diplomës” të plotësuar, sipas formatit të miratuar, të paktën 2 javë nga data e shpallur nga FTI për zhvillimin e provimit të diplomimit dhe mbrojtjen e temave të diplomës. Jo më vonë se 30 ditë nga dita e fillimit të vitit akademik, DSHK u bën të njohur studentëve të vitit të fundit programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. Drejtuesi i DSHK ngre Komisionin e Provimit të Diplomimit (KPD) për programin e studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike. KPD, nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, informon studentët rreth organizimit të provimeve të diplomimit. GVJ u informua se kriteret për mbrojtjen e një teze diplome përcaktohen me vendim të përvitshëm të Dekanatit. <i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	GVJ u informua se FTI në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si: <ul style="list-style-type: none">- Ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FTI;- Takime informuese në gjimnaze për maturantët;



<p>interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale; - Takime informuese online me grupe maturantësh në rang gjimnazesh; <p>GVJ u informua se edhe përdorimi i rrjeteve sociale si dhe faqja web e UAMD-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Në këtë drejtim një rol të veçantë luan dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/; DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. RVB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e UAMD; Rregullorja e FTI) si dhe Rregullorja e programit të studimit. - Gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmbyllëse; - Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve; - Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse; - FTI në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët - Përdorimi i rrjeteve sociale si dhe faqja web e UAMD-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të UAMD, sistemit të informacionit <i>Pitagora</i> si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (<i>Google Classroom</i>).</p> <p>Pedagogu mentor i cili caktohet nga njësia bazë në fillim të çdo viti akademik është përgjegjës për orientimin e studentëve. Ai asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI.</p> <p>Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si dhe kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).</p> <p>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/; DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca 5. Rregullore programit të studimit bachelor në Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca Takime në institucion dhe DVV Evidenca. RVB.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga shyrtimi i DVV, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se FTI shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i institucionit si dhe një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit, kurrikula si dhe kalendari akademik. Syllabuset, që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës, japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë.</p> <p>DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/orari/; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/KALENDARI-AKADEMIK-2022-2023-Bachelor.xls dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e</p>	<p>GVJ u informua se përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve studentët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e biznesit. Këta të</p>




<p>punësimin, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>fundit zhvillojnë në mënyrë periodike trajnime ose testime për identifikimin e studentëve potencial për punësim si dhe informojnë vazhdimisht studentët për kërkesat e tregut të punës dhe për mundësitë e punësimin të tyre në përfundim të programit të studimit dhe në disa raste edhe gjatë kohëzgjatjes së programit të studimit.</p> <p>Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimin, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Udhëzuesi i karrierës i përgatitur për këtë qëllim përbën një kontribut me vlerë për orientimin e studentëve. Gjatë takimit me studentë të programit të studimit GVJ u informua se shërbimi i karrierës u dërgon email-e për mundësi punësimi si dhe organizon takime informuese për tregun e punës.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Udhezuesi_i_Karrieres.pdf dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/modeli-i-planifikimit-te-karrieres/</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se DSHK mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë jetës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Gjatë javës së orientimit për studentët e vitit të parë (java e parë e mësimin), studentët informohen edhe për ambientet dhe infrastrukturën e FTI që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre. Përsa i përket ambienteve mësimore, informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin <i>Pitagora</i>.</p> <p>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/; DVV Evidenca 29.Laborator FTI dhe DVV Evidenca. https://uamd.pitagora.rash.al/.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimin, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i>, i cili ofron një akses të individualizuar në sistem dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahet dhe i mundësohet aksesimi në distancë nëpërmjet platformës Google for Education (<i>Google Drive, Google Classroom</i>).</p>



	<i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/; DVV Evidenca. https://uamd.pitagora.rash.al/ dhe DVV Evidenca. RVB.</i>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i> - <i>FTI shpërndan informacion nëpërmejt faqes së internetit ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i institucionit si dhe një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë.</i> - <i>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve.</i> - <i>Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</i> - <i>Sistemi i informacionit Pitagora, ofron një akses të individualizuar në sistem dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahet dhe i mundësohet aksesimi në distancë nëpërmjet platformës Google for Education.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4			
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e FTI është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi <i>Pitagora</i> .		
	Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve
		2019-2020	32

	<table border="1"> <tr> <td>Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"</td> <td>2020-2021</td> <td>33</td> </tr> <tr> <td></td> <td>2021-2022</td> <td>32</td> </tr> </table>	Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"	2020-2021	33		2021-2022	32	<p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrit themeltar dhe rregjistrit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standartet dhe udhëzimet e MAS.</p> <p>[Ev.:Vizitë në sekretarinë mësimore; RVB; Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike]</p>														
Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"	2020-2021	33																				
	2021-2022	32																				
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç' regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike (sistemi <i>Pitagora</i>) dhe në format letër. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin themeltar të studentëve (i gjeneraliteteve dhe notave) dhe regjistrat e lëndëve semestrale.</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standartet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Rregjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="4">Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>92</td> <td>1</td> <td>93</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>88</td> <td>1</td> <td>89</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>90</td> <td>4</td> <td>94</td> </tr> </tbody> </table> <p>DVV Evidenca shtesë. tabela 21 e azhurnuar; DVV Evidenca. Vizitë në sekretarinë mësimore dhe DVV Evidenca. https://uamd.pitagora.rash.al/.</p>	Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"				Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2020-2021	92	1	93	2021-2022	88	1	89	2022-2023	90	4	94
Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"																						
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali																			
2020-2021	92	1	93																			
2021-2022	88	1	89																			
2022-2023	90	4	94																			
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në regjistrat përkatës) si dhe në sistemin <i>Pitagora</i>, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj përmes sistemit.</p>																					

	<p>DVV Evidenca. Takime me studentë e pedagogë të programit të studimit dhe DVV Evidenca. Vizitë në sekretarinë mësimore.</p>																				
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Veprimtaria e Sekretarisë mësimore të FTI mbështetet në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FTI. Neni 64 i rregullores së FTI përcakton se Sekretaria mësimore e FTI-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Në nenet 66 dhe 67 të rregullores së FTI përcaktohen qartë detyrat e Kryesekretarisë dhe Sekretarisë mësimore. Kryesekretaria ka varësi të drejtpërdrejtë nga Dekani i FTI, i cili menaxhon procesin e kontrollit periodik të përvitshëm dhe vlerësimit e dokumentimit të gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> <p>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 4.Rregullore FTI dhe DVV Evidenca. Vizitë në sekretarinë mësimore.</p>																				
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="660 1281 1519 1451"> <thead> <tr> <th colspan="4">Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td>7.91</td> <td>7.98</td> <td>8.16</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2019-2022 janë:</p> <table border="1" data-bbox="660 1505 1506 1715"> <thead> <tr> <th>Numri total i të diplomuarve</th> <th>Të punësuarit në përputhje me diplomën</th> <th>Të punësuarit jo në përputhje me diplomën</th> <th>Të papërcaktuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>97</td> <td>30%</td> <td>37%</td> <td>33%</td> </tr> </tbody> </table> <p>DVV Evidenca shtesë. Tabela 21 e azhornuar; DVV Evidenca. Tabela Permbledhese Bachelor Shkenca Kompjuterike; DVV Evidenca 24.</p>	Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"				Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023	Nota mesatare në hyrje	7.91	7.98	8.16	Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar	97	30%	37%	33%
Bachelor në "Shkenca Kompjuterike"																					
Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023																		
Nota mesatare në hyrje	7.91	7.98	8.16																		
Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar																		
97	30%	37%	33%																		




	Analize e Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria mësimore e FTI është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, rregjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik nëpërmjet sistemit Pitagora. - Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. - Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Neni 90 i Statutit të UAMD, përcakton funksionimin në institucion të Këshillit Studentor si organizim i pavaruar i studentëve i cili promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive et. Në statut përcaktohet se UAMD mbështet këshillat studentore dhe financon veprimtarinë e tyre. Veç kësaj në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe dy përfaqësues të studentëve, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu GVJ u informua se

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>studentët përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit etj.</p> <p>DVV 1. Evidenca Statuti UAMD; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/per-hapjen-e-procesit-te-aplikimeve-per-anetar-studente-te-senatit-akademik/ dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAMD garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke certifikuar elementët e pasqyruar në raport, sidomos ata elementë që kishin të bënin me të drejtat e detyrimet e studentëve, mobilitetin e studentëve, mbështetjen financiare, diplomimin dhe punësimin e tyre. Gjithashtu, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera nëpërmjet pyetsorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin të stafit akademik nga studentët; - Vlerësimin i lëndës; - Vlerësimin i kënaqësisë së studentëve nga institucioni; - Pyetsori Alumni <p>GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p>DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. Pyetesoret e vlerësimeve; DVV Evidenca. Urdher Nr.193 date 8.5.2023 mbi vlerësimin e pedagogëve nga studentet); DVV Evidenca 28. Pyetesori Student UAMD; Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca 34. Analiza e pyetesorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UAMD. Gjithashtu, nëpërmjet pyetsorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmytet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetsori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë,</p>




<p>mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>referuar dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në tre vitet e fundit.</p> <p>GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. Pyetësoret e vlerësimeve; DVV Evidenca 28. Pyetësor Student UAMD; DVV Evidenca. Raporti i Vetevlerësimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ).</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit. Në rregulloren e FTI përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit të FTI jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore e cila shkon deri në një shikim eventual të tezës së provimit nëpërmjet një komisioni <i>ad-hoc</i>. Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p> <p><i>DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD, DVV Evidenca 4. Rregullore FTI dhe DVV Evidenca. Takim me studentët.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - UAMD garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. - Studentët në UAMD janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit. - Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të UAMD si dhe nëpërmjet përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët. - Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.

	- <i>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit. Konstatohet se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të studentëve nga ana e pedagogëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në UAMD funksionojnë struktura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës - Sekretaria Mësimore - Pedagogu mentor i cili është përgjegjës për orientimin e studentëve. <p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ofron këshillime, orientim karriere dhe seminare për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e krijimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti në tregun e punës.</p> <p>Sekretaria mësimore e FTI-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Pedagogu mentor asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI.</p> <p>GVJ konstaton se të tre këto struktura janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca. Takime në sekretarinë mësimore; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Udhezuesi_i</i></p>

	<p><i>Karrieres.pdf dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me rregjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan dhe pedagogu mentor. Qëllimi kryesor i mentorimit është asistimi, këshillimi, mbështetja e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së studimeve në FTI si dhe përpjekja për të maksimizuar rritjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën akademike, atë profesionale e më gjerë. Mentorimi është një proces edukues në të cilin pedagogu mentor shërben si mësues, inkurajues dhe këshillues me qëllimin përfundimtar të promovimit të zhvillimit profesional dhe personal të tyre. Pedagogu mentor monitoron zhvillimin e studentëve dhe ndërhyr për të ndihmuar përparimin e tyre. Ai asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI.</p> <p><i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në UAMD funksionon dhe Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Kjo zyrë është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët, nga ana e GVJ, u vu re se kjo njësi informon studentët kryesisht me anë të postës elektronike rreth mundësive për punësim.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka të parashikuar praktikë profesionale si element të veçantë në programin mësimor, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere.</p>

	<p><i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. 7 Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumnit dhe karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në raport me punësimin e të diplomuarve dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre pas punësimit, GVJ u informua se Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimin e studentëve për mundësitë e punësimit (nëpërmjet postës elektronike si dhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese); - Zhvillimin e trajnimeve; - Mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar - Krijimin dhe përditësimin e databaze për punësimin e studentëve; - Asistimin e studentëve për programe bursash jashtë vendit. - Hartimin e raporteve dhe statistikave dhe vënien në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <p><i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 7.. Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumnit dhe karrierës; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Udhezuesi_i_Karrieres.pdf dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në UAMD funksionojnë struktura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore dhe Pedagogu mentor, struktura të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. - Pedagogu mentor asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI. - Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka të parashikuar praktikë profesionale si element të veçantë në programin mësimor, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere. - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është struktura përgjegjëse në UAMD që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi punësimi, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, etj..





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ vëren se FTI e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UAMD dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 25. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim dhe DVV Evidenca shtesë 7. memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike". Në këtë aspekt është dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DSHK. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC. GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit.</p>

	<p>Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca shtesë 7. memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetsor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Garantimi i ankimimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>DVV Evidenca 4. Rregullore FTI; DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. Formulari i vlerësimit të stafi akademik nga studentet-final.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ); DVV Evidenca. Mbi informimin e lektoreve mbi rezultatit e vlerësimit të studenteve dhe DVV Evidenca. Kalendari plan veprimtari SKSC Kurrikula dhe Sigurimi i Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të</p>	<p>GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies luan NJSBC e cila njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Rezultatet e përpunuara publikohen dhe në faqen web të UAMD.</p>

mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>DVV Evidenca. https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2017/11/NjBSC-Mbi-realizimin-e-pyetesorit-per-mesimin-online.docx; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i>			
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ vëren se FTI e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UAMD dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). - Për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. - Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC; - GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetsorit të vlerësimin të lektorëve të lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. - GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e	<p>Në UAMD në nivel institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.




<p>nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Ndërsa në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve; - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program; - Koordinatorët e Programeve. <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë në nivel institucional jepen në Statut (nenet 77, 78, 79, 80, 81), ndërsa detyrat e strukturave në nivel fakulteti janë përcaktuar në Rregulloren për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. GVJ vëren se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><i>DVV Evidenca 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca 1. Statuti UAMD, Nenet 77-81 dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NjsBC në nivel institucional përbëhet nga 7 anëtarë (5 anëtarë janë përfaqësues të fakulteteve respektive, 1 anëtar është koordinatori institucional si dhe 1 anëtar student). NJBSC e FTI kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Kjo njësi monitoron dhe vlerëson proceset e sigurimit të cilësisë bazuar në manualët dhe treguesit e hartuar nga NJBSC institucionale. NJBSC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm dhe raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj.</p> <p>Në planin strategjik të UAMD, investimi në cilësinë e mësimdhënies përbën është një përparësi të Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Synohet që në vitet 2020-2025, UAMD do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies, ku modeli aktual do të plotësohet dhe kombinohet me metodologji më të kompletuara si: peer to peer, focus group, sondazhe të shpeshta, etj.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025 dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i</p>	<p>UAMD i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përmes Vendimit nr. 18 datë 24.03.2022, UAMD i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh (23.3.2026). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”</p>



<p>cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>është liçensuar përmes vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.350, datë 12.05.2010 dhe vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p>DVV Evidenca. https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-24-mars-2022 dhe DVV Evidenca. http://ams.ascal.al/ams/components/dokumentat/arkivaview.php?id=5412.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NjsBC në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin të stafit akademik nga studentët; - Vlerësimin të lëndës; - Vlerësimin të kënaqësisë së studentëve nga institucioni; - Pyetësi Alumni <p>si dhe pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrativ mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit</p> <p>GVJ konstatoi se NjsBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij.</p> <p>DVV Evidenca. <i>Takime në institucion; DVV Evidenca. Pyetesoret e vleresimeve; DVV Evidenca. Urdher Nr.193 date 8.5.2023 mbi vleresimin e pedagogeve nga studentet); Pyetesor Student UAMD; DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2021-2022 SKSC dhe DVV Evidenca 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në UAMD garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. - Në UAMD funksionon NJSBC në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore. - NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. - NJSBC në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin. - GVJ konstatoi se NjsBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mbikëqyrja e periodike e programit të studimit Bachelor në "Shkencë Kompjuterike" bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetsorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik. Departamenti i Shkencave Kompjuterike shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p> <p><i>DVV Evidenca 24. Analize e Departamentit të Shkencave Kompjuterike; DVV Evidenca shtesë 7. Memo analiza vjetore update 20-21 azhurnuar dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e</p>	<p>Në nivel institucioni hartohen raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik. Për personelin akademik janë aplikuar "Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD". Këto kriteret janë të miratuar në të gjitha nivelet dhe përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi. Megjithëse në raportet vjetore jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik, GVJ sugjeron se në to duhet të përfshihet një analizë më e detajuar e matësve sasiorë (eventualisht duke rritur gamën e</p>



<p>arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>treguesve) dhe të adresohen masat e marra për problematikat e ndryshme të evidentuara.</p> <p><i>DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2019-2020 SKSC; DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2020-2021 SKSC; DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca shtesë 7. memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit, drejtuesi i njësisë bazë si dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në rang institucioni dhe njësie kryesore. Nga takimi në institucion GVJ u informua për shtrirjen e përdorimit të pyetsorëve edhe për vlerësimin e stafit akademik nga vetë stafi si dhe vlerësimi i kërkimit shkencor në rang departamenti.</p> <p>GVJ është i mendimit se evidencat e paraqitura dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion.</p> <p><i>DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2019-2020 SKSC; DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2020-2021 SKSC; DVV Evidenca. Raporti i Vetevleresimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca shtesë 7. memo analiza vjetore update 20-21 azhornuar; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p>	<p>Studentëve u mundësohet të jenë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit edhe nëpërmjet ofrimit të mendimit të tyre nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përfshirjes në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB); - këshillimit me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamentit si edhe përdorimit të zyrave mbështetëse për këtë qëllim; - Këshillit Studentor; - Përfaqësuesit të studentëve në NJBSC; - Pjesëmarrjes në Senatin Akademik; - Pjesëmarrjes në Këshillin e Etikës; - Pjesëmarrjes në Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit.

<p>institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve nëpërmjet pyetsoreve të studentëve, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë, notën mesatare etj., gjurmimit të studentëve të diplomuar, etj.</p> <p>Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion, megjithatë GVJ, duke ju referuar nevojës së përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, sugjeron një bashkëpunim më të mirë me tregun e punës për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> <p>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca 3. Rregullore UAMD; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025 dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike". - Në nivel institucioni hartohen raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik. - Sugjerohet përfshirja në raportet e vetëvlerësimit e një analizë më të detajuar të matësve sasiore (eventualisht duke rritur gamën e treguesve) dhe adresimi për problematikat e ndryshme të evidentuara. - Evidencat e paraqitura dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion. - Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion, megjithatë GVJ, duke ju referuar nevojës së përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, sugjeron një bashkëpunim më të mirë me tregun e punës për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit GVJ konstatoi se me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit. Në planin strategjik të institucionit synohet dhe ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta studimi me universitete të huaja, sidomos të programeve që zhvillohen në gjuhën angleze. Objektiv i institucionit është edhe rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze të panoramës ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve të huaj. GVJ është i mendimit se këto objektiva strategjike do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe një përshtatje më të mirë e të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca. RVB dhe DVV Evidenca 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja "Për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë" përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UAMD, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se edhe plani strategjik i institucionit ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive menaxhimi dhe organizimi të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe DVV Evidenca 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i></p>

<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. Nga takimi me GVB, u konstatua se për hartimin e RVB dhe plotësimin e DVV ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVJ Institucional; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; DVV Evidenca. Pyetësoret e vlerësimeve; DVV Evidenca 28. Pyetësor Student UAMD; DVV Evidenca. Raporti i Vetëvlerësimit 2021-2022 SKSC dhe DVV Evidenca 34. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, në veprimtarinë e saj, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike në veçanti. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p><i>DVV Evidenca 30. Kodi Etikës UAMD; DVV Evidenca 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe DVV Evidenca. Takime në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, rezultojnë që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet "Panairi i Punës dhe Karrierës" i organizuar nga UAMD ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Në panairin e fundit, zhvilluar në prill 2022 morën pjesë rreth 200</p>

<p>ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>biznese nga Durrësi, Tirana dhe më gjerë. Gjithashtu mobilitetet Erasmus+ kanë ndihmuar në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, organizohen edhe leksione të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit.</p> <p><i>DVV Evidenca. Raporti i Vetevlerësimit 2020-2021 SKSC; DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/leksion-i-hapur-me-teme-how-to-international-alizeyour-department-and-faculty/.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UAMD menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. - Me rëndësi në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit. - Plani strategjik i institucionit ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive menaxhimi dhe organizimi të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale. - Ka një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. - NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. - Panairi i Punës dhe Karrierës, mobilitetet Erasmus+ si dhe leksione të hapura, kanë kontribuar në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Një pjesë e këtij informacioni bëhet publik nëpërmjet faqes web të institucionit dhe është i aksesueshëm nga gjithë të interesuarit. Në faqen web të UAMD bëhen publike rezultate të pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektoratit, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj.</p> <p><i>DVV Evidenca. Raporti i Vetevlerësimit 2021-2022 SKSC; DVV Evidenca. Mbi raportimin periodik për zhvillimin e mesimdhënies në klasat virtuale; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/vendime/; DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Relacion-NJSBC-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-mesimi-online.docx dhe DVV Evidenca. https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhënien-Online.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. GVJ konstaton se informacioni me rezultatet e vlerësimeve të publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit.</p> <p>DVV Evidenca. Takime në institucion dhe DVV Evidenca. Mbi informimin e lektoreve mbi rezultatin e vlerësimit të studenteve.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët. GVJ, gjatë takimeve në institucion, u informua se pas analizës së pyetësorëve është reflektuar për problematikat që lidheshin me infrastrukturën. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe Vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p>

	DVV Evidenca. Takime në institucion.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton përpjekje nga ana e UAMD-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. DVV Evidenca. Takime në institucion.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Vetë procesi i realizimit të anketimeve nëpërmjet pyetsorëve kontribon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në këtë drejtim ndikim pozitiv ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Gjithashtu, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të UAMD dhe FTI, njësia përgjegjëse për programin e studimit si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Në këtë mënyrë, GVJ konstaton se, nga një analizë e thelluar e programit të studimit gjatë hartimit të RVB, është mundësuar evidentimi i pikave të forta, dobësive, kërcënimeve dhe janë paraqitur mundësitë që paraqiten para studentëve të këtij programi. Për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. DVV Evidenca 1. Statuti UAMD; DVV Evidenca. Takime në institucion; DVV Evidenca. RVB; DVV Evidenca 25. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim.
Konkluzione	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve si dhe nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të rezultateve të përmbledhura të pyetsorëve, Statutit, Rregullores, Vendimeve të Senatit Akademik, Vendimeve të Rektoratit, Vendimeve të Bordit të Administrimit, etj.</i> - <i>GVJ konstaton se stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin në lidhje me performancën e tijndërsa Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij.</i>

	<p><i>Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>GVJ konstaton adresimin nga ana e institucionit të problematikave të evidentuara nga procesi i anketimeve me studentët, gjatë hartimit të RVB dhe të evidentuara gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe Vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional;</i> - <i>GVJ konstaton përpjekje nga ana e UAMD-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit.</i> - <i>Anketimet me studentët, pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV mundësojnë evidentimin e pikave të forta, problematikave, kërcënimeve dhe paraqesin mundësitë që paraqiten para studentëve të këtij programi.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të Parë
Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Lartë " Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike në mbështetje të programit të studimit ofrojnë hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UAMD dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;
3. Personeli akademik me përvojë në mësimdhënie dhe në fushën e shkencave kompjuterike;
4. Mbulimi i lëndëve të programit të studimit është në përputhje me fushën e ekspertizës së personelit akademik;
5. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit;
6. Institucioni aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për studentët në nevojë, si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.

Pika të dobëta

1. Organizimi i kurrikulës së programit të studimit nuk është plotësisht në përputhje me VKM.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar; Nuk jepen kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi të ciklit të parë, ndarja në kredite për këtë program sipas kategorive të veprimtarive formuese në auditor/jashtë auditorit; Ky informacion mungon dhe në syllabuset e lëndëve, ku titullarët në disa lëndë të programit të studimit nuk janë me titullin Prof. dhe Prof.As.
2. Praktika profesionale nuk përfshihet si lëndë e veçantë në planin mësimor të programit të studimit;
3. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit. Mungesë e teksteve fizike në bibliotekë për literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar e kurseve të programit të studimit.

Rekomandime

1. Institucioni të bëjë organizimin e kurrikulës së programit të studimit në përputhje të plotë me VKM Nr.41 datë 24.01.2018, e ndryshuar; të bëjë detajimin e planit mësimor me të gjithë format e mësimdhënies.
2. Institucioni duhet të rrisë të paktën në 40% numrin e orëve në auditor për këtë program studimi.

3. "Praktika profesionale" të përfshihet si lëndë e veçantë në planin mësimor të programit të studimit.
4. Institucioni të angazhohet në plotësimin e syllabuseve të lëndëve të programit të studimit, në rastet e munguara dhe të titullarit të lëndës me gradën e kërkuar, si dhe të përcaktohen temat e seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, si dhe detyrave/projekteve të kursit;
5. Institucioni të përditësojë literaturën e detyrueshme për të gjitha lëndët e programit të studimit dhe të pasurojë literaturën fizike për lëndët e programit të studimit në përputhje me programet e azhornuara të lëndëve.
6. Institucioni të angazhohet për realizimin në mënyrë periodike të studimit të tregut të punës për programin e studimit.
7. Institucioni të shtojë angazhimin dhe aplikimet për projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat përveç se mbështetjes në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në programin e studimit, do të ndihmonin në diversifikimin e të ardhurave financiare të programit të studimit.
8. Institucioni të përfshijë në raportet vjetore të vetëvlerësimit një analizë më të detajuar të matësve sasiorë dhe të adresojë masat e marra për problematikat e ndryshme të evidentuara.

**Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program "Bachelor in
"Computer Science" of Higher Education Institution "University
"Aleksandër Moisiu" Durrës"**

Strong points and affirmations

1. Appropriate facilities and didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary space and conditions for the learning process;
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of UAMD and the economic development of the country and meets the labor market needs, in accordance with the strategic goals of national economic development;
3. Academic personel with experience in education and computer science field;
4. The handling of study program courses with academic personel is in compliance with field of academic personel expertise.
5. Institution has signed several collaboration agreement to support academic and professional exchange in country and abroad.
6. The institution applies governmental policies for student scholarships for students who need support, as well as for students with high academic results.

Weak points

- 1.The organisation of study program curriculum is not fully in accordance with PM Decision No.41, date 24.01.2018, modified; The categories of didactic activity that describe this second-cycle study program are not given, nor the division of credits according to the categories of didactic activities in/out auditorium; This information is missing even in courses syllabuses of study program and in some of the them, the course holder is not with grade Prof.As or Prof;
- 2.The professional practise is not included as a separate subject in the curriculum of the study program;
- 3.The mandatory literature of the study program, in some subjects is not of the last 5 years. Lack of physical texts for mandatory and recommended literature in libraries of the study program courses.

Recommendations

1. The Institution performs the organisation of study program curriculum in accordance with CM Decision No.41, date 24.01.2018, modified; performs the study program completion with all the categories of didactic activities and respective missing information.
2. The institution must increase the number of hours in the auditorium for this study program to at least 40%.
3. The professional practise to be included as a separate subject in the curriculum of the study program.
4. The institution completes the syllabuses of the study program courses with missing elements from study program curriculum, in cases of missing define the course holder with respective grade Prof or Prof.As., as well determines the course topics of seminars, laboratories work and tasks/projects;
5. The institution updates the mandatory literature for all courses of study program and enriches the physical literature for the study program courses in accordance with updated courses program;
6. The institution commits to the periodic realization of the study of the labor market for the study program.
7. The institution increases commitment and applications for national and international research projects, which apart from supporting the quality improvement in teaching and learning in the study program, supports diversify the financial income of the study program.
8. The institution includes in the annual self-assessment reports a more detailed analysis of the quantitative measures and address the measures taken for the various identified issues.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, PROGRAMIT STUDIMIT I TË				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT STUDIMIT TË				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT STUDIMIT BACHELOR TË				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

